



Financuar nga
Bashkimi Evropian

EURALIUS
Consolidation of the
Justice System in Albania

Heqje dorë nga përgjegjësia:

Jeni të lutur të vini re se ky dokument përbën një konsolidim jozyrtar të destinuar vetëm për qëllime informimi. Teksti nuk jep asnjë të drejtë dhe nuk imponon asnjë detyrim të ndryshëm nga çfarë parashikohet në legjislacionin e miratuar dhe të botuar në Fletoren Zyrtare. EURALIUS nuk garanton saktësinë dhe nuk mban përgjegjësi për përdorimin që mund t'i bëhet informacionit të mëposhtëm.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

VENDIM

Nr. 70, datë 07.02.2020

MBI

KRITERET DHE PROCEDURAT E NGRITJES NË DETYRË TË GJYQTARËVE

Në mbështetje të nenit 147/a, pika 1, shkronja "a", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 48, pikat 9 dhe 14, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

I. QËLLIMI, FUSHA E ZBATIMIT DHE SUBJEKTET

1. Qëllimi i vendimit është përcaktimi i rregullave të detajuara për kriteret dhe procedurën që zbaton Këshilli i Lartë Gjyqësor për renditjen e gjyqtarëve që kandidojnë për ngritje në detyrë sipas Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
2. Rregullat e këtij vendimi janë të zbatueshme për renditjen e gjyqtarëve që kandidojnë dhe që përmbushin kriteret ligjore për ngritjen në detyrë në pozicionet e mëposhtme:
 - a) gjyqtar në Gjykatën e Lartë, kur ka një ose më shumë pozicione të lira;
 - b) gjyqtar në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, kur ka një ose më shumë pozicione të lira;

Ministria e Drejtësisë,
Bolevardi "Zogu I"
Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 22 40 333
E-mail: info@euralius.eu
Web: www.euralius.eu



- c) gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit, kur ka një ose më shumë pozicione të lira, të cilat nuk plotësohen nëpërmjet lëvizjes paralele;
 - ç) gjyqtar në një gjykatë apeli të juridiksionit të përgjithshëm, kur ka një ose më shumë pozicione të lira, të cilat nuk plotësohen nëpërmjet lëvizjes paralele.
3. Këto rregulla zbatohen për pozicionet e lira të përhershme dhe për aq sa është e mundur edhe për pozicionet e lira të përkohshme.
4. Këto rregulla nuk zbatohen për ngritje në detyrën e kryetarit të gjykatës, përfshirë dhe atë të Kryetarit të Gjykatës së Lartë. Rregullat e detajuara për ngritjen në detyrë në këto pozicione, bazuar në nenet 51 dhe 52 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, miratohen me vendim të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
5. Subjekte të këtij vendimi janë gjyqtarët që kandidojnë për ngritje në detyrë sipas përcaktimeve të nenit 47, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “ç”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe konkretisht:
- a) gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë;
 - b) gjyqtarët e gjykatave të apelit;
 - c) gjyqtarët në skemë delegimi;
 - ç) gjyqtarët e komanduar.

II. KUADRI LIGJOR

6. Ky vendim do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me:
- a) Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
 - b) Kodin e Procedurave Administrative;
 - c) Ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar (Ligji për Qeverisjen);
 - ç) Ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (Ligji për Statusin);
 - d) Ligjin nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;
 - dh) Ligjin nr. 9877, datë 18.02.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
 - e) Ligjin nr.8811, datë 17.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar;
 - ë) Ligjin nr. 8588, datë 15.03.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

- f) Ligjin nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar;
- g) Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”;
- gj) Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

III. PËRKUFIZIME

7. Për qëllime të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Akt vlerësimi”, nënkupton aktin e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatit, të administruar në dosjen personale të tij;
- b) “Dosje personale”, nënkupton dosjen e kandidatit sipas përcaktimeve të nenit 38 të Ligjit për Statusin;
- c) “Kandidat në procedurën e përzgjedhjes për ngritje në detyrë”, nënkupton gjyqtarin e kualifikuar për ngritjen në detyrë, i cili ka dy vlerësime etike dhe profesionale dhe nuk është i pezulluar nga detyra;
- ç) “Këshill”, nënkupton Këshillin e Lartë Gjyqësor;
- d) “Komision”, nënkupton Komisionin e Zhvillimit të Karrierës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, që përbëhet nga tre anëtarë, anëtarët e përhershëm ose zëvendësues, duke ruajtur në çdo rast kompozimin e tij sipas pikës 10, neni 62, të Ligjit për Qeverisjen;
- dh) “Ngritje në detyrë”, ka të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të Ligjit për Statusin, sipas të cilit ngritja në detyrë është kalimi nga:
 - i. një pozicion në sistemin gjyqësor, në një pozicion tjetër të një niveli më të lartë;
 - ii. një pozicion i juridiksionit të përgjithshëm civil, penal ose administrativ në një pozicion në një prej gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin të organizuar;
 - iii. një pozicion i komanduar ose pozicion në skemën e delegimit, në një pozicion të një niveli më të lartë sesa pozicioni i mbajtur para komandimit.
- e) “Nivel vlerësimi”, nënkupton rezultatin e përgjithshëm të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatit sipas sistemit të vlerësimit të kohës, përfshirë edhe atë të gradimit për periudhën e përcaktuar në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, sipas nenit 171, pika 5, të Ligjit për Statusin;
- ë) “Periudhë kalimtare”, nënkupton periudhën deri në miratimin nga Këshilli i Lartë Gjyqësor të akteve nënligjore të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve dhe të realizimit të procedurave të vlerësimit, sipas këtij ligji, por jo më vonë se afati i caktuar për përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të magistratëve, sipas përcaktimit të nenit 25 të Ligjit nr.48/2019 “Për disa shtesa dhe

- ndryshime në Ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- f) “Përvojë në pozicionet e komanduara”, nënkupton përvojën e veçantë të punës së kandidatit si gjyqtar i komanduar: në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë, në Gjykatën Kushtetuese; në pozicionin e inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; në pozicione të tjera në Këshillin e Lartë Gjyqësor, në Ministrinë e Drejtësisë, në Avokaturën e Shtetit, në Shkollën e Magjistraturës ose në çdo institucion tjetër brenda sistemit të drejtësisë dhe përafrimit të legjislacionit, sipas pikës 2, të nenit 53, të Ligjit për Statusin; në çdo pozicion tjetër të ndryshëm nga këto, kur komandimi është bërë për interes publik, sipas pikës 7, të nenit 54, të Ligjit për Statusin; si dhe në çdo pozicion ku është komanduar me vendim të institucioneve të tjera, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi përpara Ligjit për Statusin, në rastin kur gjyqtari ka kryer të gjithë periudhën e komandimit;
- g) “Përvojë profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë”, nënkupton përvojën e veçantë të punës së kandidatit në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë të shpallur;
- gj) “Pikëzim”, nënkupton vlerësimin me pikë të secilit kriter sipas sistemit të vlerësimit etik dhe profesional të rregulluar nga Ligji për Statusin dhe me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor:
- i. Vendimin nr. 263, datë 21.11.2019, “Për rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe Vendimin nr.264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”; ose
- ii. Vendimin nr.102, datë 05.07.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë” dhe Vendimin nr.209, datë 11.10.2019, “Metodologjia për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë” për kandidatin e komanduar që nuk i është bërë vlerësim etik dhe profesional nga institucioni i sistemit të drejtësisë;
- h) “Pozicion i lirë i përhershëm”, nënkupton atë pozicion në gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm dhe atë administrativ, në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar ose në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka gjyqtar me të drejtën për t’u kthyer në atë pozicion, i shpallur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për t’u plotësuar nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë;
- i) “Pozicion i lirë i përkohshëm”, nënkupton atë pozicion në një gjykatë kur gjyqtari që e ka atë në mënyrë të përhershme, për të paktën 3 muaj, është përkohësisht në pamundësi për të ushtruar funksionin në këtë pozicion, por që ka të drejtën për t’u kthyer, sipas përcaktimit të bërë në nenin 42, pika 2, fjalia e tretë dhe pika 4, të Ligjit për Statusin;
- j) “Procedurë përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë”, nënkupton procesin administrativ të renditjes dhe përzgjedhjes, sipas rastit, kandidatin ose kandidatët e renditur më lart;

- k) “Relator”, nënkupton anëtarin e përhershëm ose zëvendësues të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, që zgjidhet me short për të realizuar një procedurë përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë;
- l) “Vendim kualifikimi”, nënkupton vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor të marrë në përfundim të procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit, të pasurisë dhe të figurës, sipas Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”;
- ll) “Vendim për renditjen e kandidatëve”, nënkupton vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor të marrë në përfundim të një procedure përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë, me përjashtim në Gjykatën e Lartë, bazuar në kriteret e përcaktuara në nenin 48, pika 9, të Ligjit për Statusin, si dhe në rregullat e detajuara për kriteret dhe procedurën të përcaktuara në këtë Vendim;
- m) “Vendim paraprak i propozimit për emërim”, nënkupton vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor për renditjen e kandidatëve për në Gjykatën e Lartë dhe propozimin për emërim të kandidatit të renditur më lart;
- n) “Vendim për ngritjen në detyrë”, nënkupton vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor për ngritjen në detyrë të kandidatit të renditur më lart në një procedurë përzgjedhjeje, me përjashtim në Gjykatën e Lartë;
- nj) “Vendim përfundimtar i propozimit për emërim”, nënkupton vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor për propozimin për emërim Presidentit të Republikës të kandidatit të renditur më lart, në përfundim të një procedure përzgjedhjeje, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë;
- o) “Vjetërsi si gjyqtar”, nënkupton përvojën e përgjithshme të punës së kandidatit, si gjyqtar, si gjyqtar i komanduar në institucionet e sistemit të drejtësisë dhe si anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- p) “Vjetërsi si jurist”, nënkupton përvojën e përgjithshme të punës së kandidatit si jurist në institucione publike, subjekte shtetërorë ose private;
- q) “Vlerësime të mëparshme”, nënkupton dy vlerësimet më të fundit etike dhe profesionale të kandidatit.

IV. Hapat, kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve

A. Të përgjithshme

- 8. Renditja e kandidatëve bëhet me qëllim përzgjedhjen e kandidatit më të mirë për pozicionin e lirë.
- 9. Për renditjen e kandidatëve ndiqen deri në tre hapa, ku në secilin prej tyre bëhet një vlerësim krahasues i treguesve të kritereve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 48, pika 9, të Ligjit për Statusin, si dhe të detajuara më poshtë në këtë Vendim.

10. Hapi pasues i renditjes ndiqet vetëm nëse në përfundim të hapit paraardhës nuk arrihet të bëhet renditja e kandidatëve me rezultate të njëjta më të larta.
11. Hapi i dytë i renditjes ndiqet vetëm kur për pozicionin e lirë kërkohet përvojë profesionale specifike.

B. Hapi i parë, kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve

12. Renditja e kandidatëve bazohet në vlerësimin krahasues të niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale. Kandidati me nivelet më të larta të vlerësimit etik dhe profesional, renditet më lart.
13. Në rastin e kandidatit të komanduar në një institucion brenda sistemit të drejtësisë, niveli i vlerësimit etik dhe profesional nga ky institucion, njihet si nivel vlerësimi edhe në kuptim të këtij Vendimi, duke mbajtur në konsideratë në këtë rast nivelet e vlerësimit sipas ligjit të posaçëm të institucionit të sistemit të drejtësisë dhe nivelet e vlerësimit sipas sistemit të kohës për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve.
14. Në rastin kur kandidatit të komanduar nuk i është bërë vlerësim etik dhe profesional nga institucioni i sistemit të drejtësisë, atëherë ai vlerësohet për aftësitë profesionale si kandidati jogjyqtar në Gjykatën e Lartë, sipas parashikimeve të nenit 49 të Ligjit të Statusit dhe vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Vendimit nr.102, datë 05.07.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë” dhe Vendimit nr.209, datë 11.10.2019, “Metodologjia për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”. Në këtë rast, nivelet e vlerësimit sipas pikëve janë si më poshtë:

Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	90 - 100
Shumë mirë	70 - 89
Mirë	50 - 69
Mjaftueshëm	30 - 49
I pamjaftueshëm	1 - 29

15. Në rast se ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, për renditjen e kandidatëve me rezultatet më të larta zbatohen përparësitë sipas radhës së mëposhtme:
- a) “niveli i vlerësimit të fundit” - Sipas kësaj përparësie, kandidati me nivelin më të lartë të vlerësimit të fundit etik dhe profesional, renditet më lart;

- b) “përvoja si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit” - Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka një nga këto përvoja, renditet më lart.
 - c) “kohëzgjatja e përvojës si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit” - Sipas kësaj përparësie, kandidati me përvojën me kohëzgjatjen më të madhe në vite, renditet më lart;
 - ç) “shumëllojshmëria e përvojave si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit ose si anëtar i Këshillit” - Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka më shumë nga këto përvoja, renditet më lart;
16. Në rast se edhe pas zbatimit të përparësive sipas pikës 15 ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në skemën e pikëve të miratuar nga Këshilli me:
- a) Vendimin nr. 263, datë 21.11.2019, “Për rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe Vendimin nr.264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”; ose
 - b) Vendimin nr.102, datë 05.07.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë” dhe Vendimin nr.209, datë 11.10.2019, “Metodologjia për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”.
17. Në rastin e një kandidati me rezultate më të larta, për të cilin zbatohet skema e pikëve sipas shkronjës “b”, të pikës 16, të këtij vendimi, pikët sipas kësaj skeme konvertohen në raportin një me katër me ato të skemës sipas shkronjës “a”, të kësaj pike të vendimit.
18. Sipas kriterit të renditjes të parashikuar në pikën 16, të këtij vendimi, kandidati me totalin më të lartë të pikëve në dy vlerësimet e mëparshme etike dhe profesionale, renditet më lart.

C. Hapi i dytë, kriteri dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve

19. Në rast se pas vlerësimit të bërë sipas Seksionit B, ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në përvojën profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë. Kandidati që ka përvojë profesionale specifike, renditet më lart.

20. Në rast se edhe pas kësaj ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, për renditjen e kandidatëve me rezultatet më të larta merr përparësi kohëzgjatja e përvojës profesionale specifike. Kandidati me përvojën profesionale specifike me kohëzgjatjen më të madhe, renditet më lart.

Ç. Hapi i tretë, kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve

21. Në rast se pas vlerësimit të bërë sipas Seksionit B dhe, kur është rasti edhe sipas Seksionit C, të këtij Kreu, ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në vjetërsinë si gjyqtar. Kandidati me vjetërsinë më të madhe, renditet më lart.

22. Në rast se edhe pas kësaj ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, për renditjen e kandidatëve me rezultatet më të larta merr përparësi zhvillimi i karrierës si gjyqtar. Kandidati me karrierë më të zhvilluar, renditet më lart.

23. Në rast se edhe pas kësaj ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në vjetërsinë si jurist. Kandidati me vjetërsinë më të madhe, renditet më lart.

V. Rregulla të përgjithshme të procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë

A. Fillimi i procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë dhe caktimi i relatorit

24. Këshilli, jo më vonë se 7 ditë nga vendimi i parë për kualifikimin e një kandidati, vendos fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, si dhe cakton, nëpërmjet shortit, relatorin për atë procedurë. Për arsye të motivuara, mbi kërkesën e çdo anëtari të Komisionit, Këshilli mund të vendosë përjashtimin e tij nga shorti.

25. Përjashtimisht, për arsye të motivuara që lidhen me ngarkesën dhe efektivitetin e punës, mbi propozimin e Komisionit, Këshilli mund të vendosë që në procedurat e shortit për caktimin e relatorit, në një ose disa procedura përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë, të përfshihen edhe anëtarët zëvendësues të Komisionit.

26. Anëtari i Komisionit dhe/ose çdo anëtar tjetër i Këshillit, në çdo kohë kur merr dijeni për ekzistencën e një konflikti interesi ose të një pengese ligjore sipas neneve 72, 73, 74 dhe 75 të Ligjit për Qeverisjen, është i detyruar të deklarojë natyrën e konfliktit të interesit ose pengesës dhe të heqë dorë nga pjesëmarrja në procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë për atë pozicion të lirë.

27. Anëtari i Komisionit dhe/ose çdo anëtar tjetër i Këshillit, që më herët ka dhënë dorëheqjen ose është përjashtuar në një procedurë verifikimi të kriterëve ligjore të kandidimit, të pasurisë dhe të figurës për

një nga kandidatët që konkurron për pozicionin e lirë për të cilin zhvillohet procedura e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, nuk mund të marrë pjesë në këtë procedurë në rast se konflikti i interesit ose pengesa ligjore për shkak të të cilit ai ka dhënë dorëheqjen ose është përjashtuar, vijon të ekzistojë.

28. Për dorëheqjen e çdo anëtari të Këshillit vendos Kryetari i tij. Kur dorëheqjen e jep Kryetari i Këshillit, vendimi merret nga Zëvendëskryetari i tij.
29. Kur në një gjykatë, për të njëjtën fushë të së drejtës, ka më shumë se një pozicion të lirë, Këshilli kryen vetëm një procedurë përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë.

B. Të drejtat e kandidatit

30. Kandidati njoftohet për relatorin menjëherë me fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë.
31. Kandidati ka të drejtë të kërkojë përjashtimin e relatorit për një nga shkaqet e parashikuara në nenin 75 të Ligjit për Qeverisjen, jo më vonë së 3 ditë, nga marrja dijeni e shkakut të përjashtimit, duke shoqëruar kërkesën, kur është rasti, me aktet provuese të shkakut të përjashtimit. Këtë të drejtë kandidati e ka edhe ndaj çdo anëtari tjetër të Këshillit.
32. Këshilli vendos për kërkesën e kandidatit për përjashtimin e relatorit të çështjes dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, jo më vonë së 7 ditë nga paraqitja e saj.
33. Kandidati ka të drejtë që, në çdo fazë të procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, me kërkesë, të njihet me dokumentet e dosjes së tij, si edhe të marrë kopje të tyre, sipas rregullave të Kodit të Procedurave Administrative.
34. Kandidati, që ka qenë i komanduar në një institucion brenda sistemit të drejtësisë dhe ky i fundit nuk ka bërë vlerësimin e tij etik dhe profesional, ka të drejtë që, në momentin e aplikimit për ngritjen në detyrë, të kërkojë bërjen e këtij vlerësimi nga Këshilli sipas rregullave përkatëse të vlerësimit.
35. Kryesisht, apo mbi kërkesën e Këshillit, kandidati ka të drejtë të paraqesë shpjegime me shkrim për fakte, rrethana apo çështje ligjore që lidhen me kriteret e renditjes, si dhe të depozitojë, kur është rasti, dokumente shkresore në mbështetje të këtyre shpjegimeve.
36. Kandidati ka të drejtë të tërhiqet nga kandidimi derisa nuk ka përfunduar procedura e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, duke depozituar kërkesën e tij me shkrim. Mbi këtë kërkesë, me propozim të relatorit të çështjes, Këshilli vendos përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për këtë kandidat

dhe përjashtimin e tij nga procedurat e mëtejshme të kandidimit. Vendimi i Këshillit i njoftohet kandidatit dhe bëhet publik në faqen e tij zyrtare.

C. Afatet dhe llogaritja e tyre

37. Afatet në procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë caktohen në ditë kalendarike.
38. Përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe në ligj ose në këtë Vendim, në llogaritjen e afatit përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja, nga e cila fillon të ecë afati.
39. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj.
40. Dita e fundit e afatit vazhdon deri në orën 24.00 të saj.

Ç. Njoftimet

41. Njoftimet dhe kërkesat e Këshillit drejtuar kandidatit dhe anasjelltas, si rregull bëhen në rrugë elektronike. Ato konsiderohen të marra ditën e nesërme të dërgimit në rrugë elektronike.
42. Adresa elektronike e Këshillit i bëhet e ditur kandidatit me njoftimin e fillimit të procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë.
43. Adresë elektronike e kandidatit konsiderohet adresa zyrtare e tij, por ai mund të zgjedhë një adresë tjetër elektronike, duke ia bërë atë të ditur në kohë Këshillit. Kandidati merr masa për aksesueshmërinë e adresës së tij elektronike.

VI. Fazat e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë

A. Fazat e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë

44. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve për ngritjen në detyrë realizohet në tre faza:
 - a) veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit, përfshirë kur është rasti edhe ato për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatit që ka qenë i komanduar në një institucion brenda sistemit të drejtësisë dhe ky i fundit nuk ka bërë vlerësimin e tij etik dhe profesional;

- b) shqyrtimi dhe miratimi nga Komisioni i projektvendimit të renditjes së kandidatëve ose i projektvendimit paraprak të propozimit për emërim;
- c) shqyrtimi dhe miratimi nga Këshilli i projektvendimit të renditjes së kandidatëve ose i projektvendimit paraprak të propozimit për emërim.

B. Veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit

45. Procedura e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë zhvillohet paralelisht:

- a) me procedurat e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit, të pasurisë dhe të figurës për kandidatët e tjerë që konkurrojnë për atë pozicion të lirë.
- b) me procedurat e vlerësimit dhe pikëzimit për kandidatët e tjerë që konkurrojnë për atë pozicion të lirë, të cilët kanë qenë të komanduar në një institucion brenda sistemit të drejtësisë dhe ky i fundit nuk ka bërë vlerësimin e tyre etik dhe profesional.

46. Vetëm kandidatët e kualifikuar dhe që kanë dy vlerësime etike dhe profesionale bëhen pjesë e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë për atë pozicion të lirë.

47. Relatori kujdeset për zhvillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për ngritjen në detyrë dhe në veçanti për:

- a) administrimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit të kandidatëve, që gjenden në dosjen e tyre personale apo që paraqitet nga ata gjatë procedurës së përzgjedhjes;
- b) përgatitjen e relacionit që përmban përshkrimin e veprimeve të kryera dhe të dokumenteve të administruara gjatë procedurës së përzgjedhjes, si dhe një përmbledhje faktike të tyre për aq sa është e nevojshme për renditjen e kandidatëve, duke i bashkëlidhur atij kopje të këtyre dokumenteve;
- c) përgatitjen e projektvendimit të renditjes së kandidatëve ose të projektvendimit paraprak të propozimit për emërim;
- ç) koordinimin me Kryetarin e Komisionit për përgatitjen e mbledhjes së Komisionit;
- d) koordinimin me Kryetarin e Këshillit për përgatitjen e mbledhjes plenare të Këshillit;
- dh) njoftimet për kandidatët.

48. Në ushtrimin e përgjegjësisë të tij relatori ndihmohet nga Njësia Mbështetëse e Komisioneve dhe personeli administrativ i Këshillit, të cilët kanë detyrimin të ndjekin procedurat, të kryejnë veprimet dhe të përgatisin aktet përkatëse, sipas udhëzimeve të relatorit.
49. Dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative dhe të Ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” mbi paanësinë e administratës publike zbatohen edhe për nëpunësit e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve dhe personelin administrativ të Këshillit.
50. Nëse nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes personale, relatori i çështjes vlerëson se ka mangësi, njofton menjëherë kandidatin, duke i caktuar një afat jo më shumë se 5 ditë, për të dhënë sqarime ose për të plotësuar mangësitë. Mungesa e përgjigjes së kandidatit nuk pengon vijimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë.
51. Kur është rasti, relatori mund të kërkojë nga subjekte publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, sqarime, të dhëna ose kopje të dokumenteve të konfirmuara zyrtarisht prej tyre.
52. Në përfundim të veprimeve për të gjithë kandidatët në procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në një pozicion të lirë, relatori njofton Kryetarin e Komisionit dhe i paraqet për shqyrtim Komisionit relacionin dhe dokumentacionin e përgatitur për procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, si dhe projektvendimin për renditjen e kandidatëve.
- C. Shqyrtimi dhe miratimi nga Komisioni i projektvendimit të renditjes së kandidatëve ose i projektvendimit paraprak të propozimit për emërim**
53. Kryetari i Komisionit, menjëherë pas njoftimit nga relatori për çështjen e përgatitur për shqyrtim, thërret mbledhjen e Komisionit, duke marrë masa për njohjen e anëtarëve me materialet e çështjes.
54. Në mbledhjen e Komisionit, relatori paraqet përmbledhjen e veprimeve procedurale dhe verifikuese të kryera, si edhe të fakteve që kanë rezultuar gjatë zhvillimit të procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë të kandidatëve.
55. Komisioni, pasi dëgjon relatorin, nëse vlerëson që procedura e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë dhe dokumentacioni përkatës i kandidatëve është i paplotë, i kërkon relatorit plotësimin e procedurës apo të dokumentacionit të nevojshëm, duke evidentuar sipas rastit veprimet procedurale dhe/ose dokumentacionin, për të cilët lind nevoja e plotësimit apo saktësimit. Në rast të kundërt, Komisioni vendos për kalimin e çështjes për shqyrtim në Këshill.

Ç. Shqyrtimi dhe miratimi nga Këshilli i projektvendimit të renditjes së kandidatëve ose i projektvendimit paraprak të propozimit për emërim

56. Kryetari i Këshillit, menjëherë pas njoftimit nga relatori për çështjen e përgatitur për shqyrtim, thërret mbledhjen e Këshillit, duke i dërguar anëtarëve edhe materialet e çështjes.

57. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes së Këshillit, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i njoftohet kandidatëve.

58. Në mbledhjen e Këshillit, Kryetari i Këshillit fton relatorin të paraqesë përmbledhjen e veprimeve procedurale të kryera, si edhe të fakteve që kanë rezultuar gjatë zhvillimit të procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë të kandidatëve për atë pozicion të lirë.

59. Në përfundim të parashtrimeve të relatorit, nëse vlerësojnë, anëtarët e Këshillit mund t'i drejtojnë pyetje dhe të kërkojnë shpjegime të natyrës sqaruese.

60. Më pas Këshilli kalon në fazën e bisedimit dhe vendos për këto çështje, sipas rendit të mëposhtëm:

- a) plotësinë e veprimeve procedurale dhe verifikuese të kryera nga relatori dhe plotësinë e dokumentacionit të nevojshëm për renditjen e kandidatëve;
- b) miratimin e projektvendimit të renditjes së kandidatëve ose të projektvendimit paraprak të propozimit për emërim sikundër ai është propozuar nga relatori apo me ndryshime sipas propozimeve të çdo anëtari.

61. Nëse gjatë bisedimeve Këshilli vlerëson dhe vendos që veprimet procedurale të kryera nga relatori dhe/ose dokumentacioni i nevojshëm për renditjen e kandidatëve nuk është i plotë, atëherë nuk vijon me bisedimin e projektvendimit të renditjes së kandidatëve ose të projektvendimit paraprak të propozimit për emërim, por cakton një seancë tjetër për shqyrtimin e çështjes. Në këtë rast, Këshilli ngarkon relatorin të marrë masa për plotësimin sa më parë të mangësive të evidentuara. Në seancën e radhës, që caktohet jo më vonë së 7 ditë nga njoftimi i relatorit, ky i fundit paraqet para Këshillit aktet shtesë. Në këtë rast, Këshilli vijon bisedimet dhe vendos për çështjet e renditura në pikën 60 të këtij Vendimi.

62. Në përfundim të bisedimeve, Këshilli voton projektvendimin e renditjes së kandidatëve ose të projektvendimit paraprak të propozimit për emërim. Anëtarët votojnë në të njëjtën kohë. Në përfundim të votimit, Kryetari deklaron rezultatin e votimit. Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e Kryetarit të Këshillit është përcaktuese.

VII. Vendimi për renditjen e kandidatëve dhe vendimi paraprak i propozimit për emërim. E drejta e ankimit

63. Vendimi i Këshillit për renditjen e kandidatëve dhe vendimi paraprak i propozimit për emërim arsyetohen nga relatori, jo më vonë së 10 ditë nga miratimi, duke reflektuar çdo sugjerim për të cilin kanë rënë dakord shumica e anëtareve të Këshillit. Vendimi nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Këshillit që kanë marrë pjesë në votim.
64. Vendimi i arsyetuar i Këshillit iu njoftohet kandidatëve.
65. Kundër vendimit të Këshillit mund të bëhet ankim nga çdo kandidat, në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit. Gjykata merr vendimin brenda dy javëve nga dita e ankimit. Vendimi i gjykatës është i formës së prerë.
66. Në rastin kur Gjykata Administrative e Apelit pranon ankimin e kandidatit/kandidatëve dhe shfuqizon vendimin, Këshilli, brenda dy javëve nga njoftimi i vendimit gjyqësor, rishikon vendimin e tij në masën e nevojshme për zbatimin e vendimmarrjes së gjykatës.
67. Vendimi i formës së prerë për renditjen e kandidatëve dhe vendimi paraprak i propozimit për emërim, bëhen publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

VIII. Vendimi për ngritjen në detyrë

68. Jo më vonë se 7 ditë nga marrja formë të prerë sipas ligjit të vendimit për renditjen e kandidatëve në një procedurë përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë, mbi projektvendimin e përgatitur nga relatori i asaj procedure, Këshilli merr vendim për ngritjen në detyrë në atë pozicion të lirë të kandidatit të renditur më lart. Në rastin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në një gjykatë, për më shumë se një pozicion të lirë në të njëjtën fushë të së drejtës, Këshilli merr vendim për ngritjen në detyrë në ato pozicione të lira të kandidatëve të renditur më lart.
69. Vendim i Këshillit për ngritjen në detyrë i njoftohet kandidatit të ngritur në detyrë, gjykatave respektive, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

IX. Vendimi përfundimtar i propozimit për emërim në Gjykatën e Lartë

70. Jo më vonë se 7 ditë nga marrja formë të prerë sipas ligjit të vendimit paraprak të propozimit për emërim në një procedurë përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, mbi projektvendimin e përgatitur nga relatori i asaj procedure, Këshilli merr vendimin përfundimtar të propozimit për emërim në atë pozicion të lirë të kandidatit të renditur më lart. Në rastin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për më shumë se një pozicion të lirë në të

njëjtën fushë të së drejtës, Këshilli merr vendim përfundimtar të propozimit për emërim në ato pozicione të lira të kandidatëve të renditur më lart.

71. Vendimi përfundimtar i Këshillit për propozim për emërim në Gjykatën e Lartë i dërgohet menjëherë Presidentit të Republikës, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.
72. Në rastin kur Presidenti i Republikës nuk shprehet brenda 10 ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të Këshillit, kandidati i propozuar shpallet i emëruar dhe fillon detyrën brenda 15 ditëve nga data e vendimit të Këshillit, pas bërjes, gjatë këtij afati, të ceremonisë së betimit përpara Presidentit të Republikës.
73. Në rastin kur Presidenti i Republikës dekreton mosemërimin në Gjykatën e Lartë të kandidatit të propozuar, ky dekret shqyrtohet nga Këshilli, jo më vonë se një javë nga depozitimi i tij pranë Këshillit.
74. Dekreti i Presidentit të Republikës për mosemërimin e kandidatit humbet fuqinë kur kundër tij voton shumica e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit, jo më pak se gjashtë anëtarë. Në këtë rast kandidati i propozuar shpallet i emëruar dhe fillon detyrën brenda 15 ditëve nga data e vendimit të Këshillit, pas bërjes, gjatë këtij afati, të ceremonisë së betimit përpara Presidentit të Republikës.
75. Nëse Dekreti i Presidentit të Republikës mbetet në fuqi, Këshilli, në të njëjtën mbledhje, vendos për rihapjen e procesit të kandidimit të gjyqtarëve për atë pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë ose propozon për emërim kandidatin e renditur i dyti më lart, propozim ky që i dërgohet menjëherë Presidentit të Republikës.

X. Dispozita për periudhën kalimtare

76. Gjatë periudhës kalimtare sipas nenit 25, paragrafi 3, të Ligjit nr. 48/2019, për renditjen e kandidatëve në një procedure përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë zbatohen rregullat e Seksionit B, Kreu IV, të këtij Vendimi, përveç sa parashikohet ndryshe në këtë Kre.
77. Kriteri i renditjes së “dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale” sipas pikës 12 të këtij Vendimi, si rregull, konsideron vlerësimet e bëra sipas Ligjit për Statusin dhe vendimeve përkatëse të Këshillit në zbatim të tij, përfshirë dhe gradimin për periudhën e përcaktuar në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë sipas nenit 171, pika 5, të këtij ligji.
78. Për çdo kandidat, me përjashtim të atij që ka qenë në një pozicion të komanduar në vitin e fundit kalendarik, si vlerësim i dytë për kriterin e renditjes së “dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, konsiderohet ai i bërë sipas Ligjit të Statusit dhe rregullave të parashikuara në nenin

22, Kreu V, të Vendimit të Këshillit nr.263, datë 21.11.2019, “Për rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”. Këshilli fillon menjëherë procedurën e vlerësimit etik dhe profesional sipas këtyre rregullave për çdo kandidat.

79. Për kandidatin që është në pozicione të komanduara në momentin e aplikimit për ngritjen në detyrë, si vlerësim i dytë për kriterin e renditjes së “dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, konsiderohet ai i bërë nga institucioni i drejtësisë ku kandidati është i komanduar ose, në rast të mospasjes së një vlerësimi të tillë, si vlerësim i dytë konsiderohet ai i bërë nga Këshilli sipas nenit 49 të Ligjit të Statusit, Vendimit të tij nr.102, datë 05.07.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë” dhe Vendimit të tij nr.209, datë 11.10.2019, “Metodologjia për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”. Në këtë rast, Këshilli fillon menjëherë procedurën e vlerësimit etik dhe profesional sipas këtyre rregullave për çdo kandidat.

80. Si vlerësim i parë për kriterin e renditjes së “dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, sipas rastit, konsiderohet:

- a) Gradimi sipas nenit 171, pika 5, të Ligjit për Statusin, për ata kandidatët që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Procesi i gradimit fillon menjëherë në momentin e aplikimit për ngritjen në detyrë; ose në pamundësi të tij,
- b) Vlerësimi i fundit etik dhe profesional sipas sistemeve të vlerësimit që kanë qenë në fuqi përpara Ligjit për Statusin, për të gjithë kandidatët e tjerë. Konvertimi i niveleve të vlerësimit sipas sistemeve të mëparshme të vlerësimit etik dhe profesional me ato sipas sistemit të vlerësimit në fuqi (Ligjit për Statusin) bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Niveli i vlerësimit sipas sistemeve të mëparshme të vlerësimit etik dhe profesional	Niveli i vlerësimit sipas sistemit të vlerësimit etik dhe profesional në fuqi (Ligjit për Statusin)
Shumë mirë	Shkëlqyeshëm
Mirë	Mirë
Mjaftueshëm	Mjaftueshëm
I pamjaftueshëm	I pamjaftueshëm

81. Në rastin e kandidatëve me rezultate të njëjta, me të larta, që si vlerësim të parë, për kriterin e renditjes së “dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, kanë vlerësimin sipas sistemeve të vlerësimit që kanë qenë në fuqi përpara Ligjit për Statusin, për renditjen e tyre sipas pikave 16 dhe

17 të këtij Vendimi, merren në konsideratë pikët e përcaktuara për ata në vlerësimin e fundit etik dhe profesional sipas Ligjit për Statusin.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

KRYETARE

NAUREDA LLAGAMI